



Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

KOPSHTARI

Niveli III në KSHK¹, referuar nivelit III të KEK²

H5-III-24

Tiranë, 2024

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Përmbajtja

Emërtimi i kualifikimit	3
Kodi.....	3
Kohëzgjatja	3
Niveli.....	3
Qëllimi:	3
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	3
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	3
Ofruesit	3
Data e validimit.....	3
Data e miratimit	3
Variantet e mëparshme	3
STRUKTURA E KUALIFIKIMIT.....	4
Kompetenca të përgjithshme.....	4
NjN-08-III-0044-24 Planifikimi dhe organizimi i punës në kopshtari	4
Rezultatet e të nxënit në njohuri	4
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	5
Kritere vlerësimi	5
NjN-08-III-0045-24 Kushtet klimatike dhe tokësore	5
Rezultatet e të nxënit në njohuri	5
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	6
Kritere vlerësimi	6
NjN-08-III-0046-24 Teknologjia e prodhimit të bimëve zbukuruese dhe dekorative	6
Rezultatet e të nxënit në njohuri	6
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	7
Kritere vlerësimi	7
NjN-08-III-0047-24 Produktet përfundimtare të bimëve zbukuruese dhe dekorative	8
Rezultatet e të nxënit në njohuri	8
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	8
Kritere vlerësimi	8
NjN-23-III-0013-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere	8
Rezultatet e të nxënit në njohuri	9
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	9
Kritere vlerësimi	9
NjN-22-III-0014-24 Komunikimi dhe etika profesionale	10
Rezultatet e të nxënit në njohuri	10
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	10
Kritere vlerësimi	10
NjN-08-III-0048-24 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në kopshtari	10
Rezultatet e të nxënit në njohuri	10
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	11
Kriteret e vlerësimit	11
Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:	11
Modalitetet e vlerësimit	12
Informacion shtesë	12
SHËNIM	13

Emërtimi i kualifikimit	KOPSHTARI			Kodi H5-III-24
	Kohëzgjatja	900-1100 orë ³	Niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK	
Qëllimi:	Qëllimi i kualifikimit profesional “Kopshtari”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, është të përgatisë punonjës të kualifikuar për rritjen dhe kultivimin e bimëve zbukuruese dhe dekorative. Ky kualifikim profesional mundëson rritjen e alternativave për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejtë me kopshtarinë, si dhe zhvillimin e personalitetit të individit për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	Në institucionet e arsimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional në “Kopshtari” të nivelit III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që: kanë përfunduar kualifikimin profesional “Bujqësi”, nivelin II në KSHK, referuar nivelit II të KEK,; – janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. – Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, institucionet përgjegjëse përgatit udhëzime të veçanta me kriteret e posaçme pranimi për këto shkolla.			
Mundësitë e kualifikimit të mëtijshëm dhe të punësimit:	Përfundimi me sukses i arsimit profesional në kualifikimin profesional “Kopshtari”, III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Suplementin përkatës, që përkon me nivelin e punonjësit të kualifikuar në këtë fushë profesionale në tregun e punës. Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës për: t’u punësuar në ndërmarrje publike ose biznese private të kopshtarisë; të shërbyer në kopshte në zonat urbane dhe rurale; njësi të rritjes dhe tregtimit të bimëve të kopshtarisë, si dhe të vetëpunësohet në sipërmarrje individuale. Në përfundim të këtij niveli, individi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, (teknik/menaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin përkatës, për të fituar të drejtën e diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.			
Ofruesit	Ky kualifikim duhet të ofrohet nga ofrues të akredituar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.			
Data e validimit				
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	H-II-06-14, H5-III-19			

³ Orë mësimore 45 minuta

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Në përfundim të kualifikimit profesional “Kopshtari” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individi do të zotërojë njohuritë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të përgjithshme janë të vlefshme për të gjitha njësitë e të nxënit.

1. Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
2. Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
3. Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
4. Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
5. Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
6. Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
7. Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
8. Të organizojë drejt procesin e të nxënit të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
9. Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
10. Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

NjN-08-III-0044-24 Planifikimi dhe organizimi i punës në kopshtari

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë sektorët/nënsektorët e bujqësisë sipas karakteristikave të tyre;
2. Të përshkruajë zhvillimet e fundit në fushën e kopshtarisë;
3. Të klasifikojë llojet e bimëve zbukuruese dhe dekorative;
4. Të përshkruajë elementet kryesorë të arkitekturës së peizazhit;
5. Të përshkruajë mënyrat e planifikimit të punës ditore, javore dhe mujore;
6. Të përshkruajë rëndësinë e organizimit të vendit të punës në mënyrë ergonomike;
7. Të shpjegojë mënyrën e përdorimit të mjeteve, materialeve dhe pajisjeve të punës, sipas funksionit;
8. Të shpjegojë mënyrat e kontrollit të gatishmërisë për punë të mjeteve dhe pajisjeve të punës;
9. Të përshkruajë mënyrat e pastrimit dhe mirëmbajtjes së mjeteve, pajisjeve dhe vendit të punës;
10. Të shpjegojë mënyrën e planifikimit të burimeve njerëzore sipas kualifikimeve përkatëse;
11. Të shpjegojë mënyrat e planifikimit të kohës dhe radhës së punës;
12. Të përshkruajë mënyrat e bashkëpunimit me eprorët dhe specialistë të tjerë të kopshtarisë;

13. Të përshkruajë mënyrat e raportimit tek eprori.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të organizojë punën për realizimin e veprimtarive;
2. Të menaxhojë burimet e nevojshme për realizimin e punës;
3. Të dokumentojë dhe raportojë realizimin e detyrave sipas procedurave.

Kritere vlerësimi

- Kryen planifikimin dhe organizimin e një kopshti, sipas parimeve;
- Kryen menaxhimin dhe monitorimin e një kopshti, sipas parimeve;
- Organizon në mënyrë ergonomike vendin e punës;
- Përcakton detyrat dhe prioritetet e një plani prodhimi ditor, javor dhe mujor në përputhje me objektivat;
- Zbaton rregullat e higjienës së vendit të punës, sipas standardeve;
- Planifikon kohën dhe radhën e punës, sipas teknologjive të kultivimit të kulturave kopshtare;
- Planifikon mjetet, materialet dhe pajisjet e punës, sipas proceseve të punës dhe funksionit të tyre;
- Përzgjedh mjetet, materialet dhe pajisjet e punës, sipas proceseve të punës dhe funksionit të tyre;
- Kontrollon funksionalitetin e mjeteve dhe pajisjeve të punës, sipas manualeve të përdorimit;
- Kryen pastrimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve, pajisjeve dhe vendit të punës, sipas procedurave;
- Planifikon burimet e nevojshme njerëzore sipas proceseve të punës dhe kualifikimit përkatës të tyre;
- Përzgjedh burimet e nevojshme njerëzore sipas proceseve të punës dhe kualifikimit përkatës të tyre;
- Zbërthen projektin e arkitekturës së peizazhit sipas rregullave;
- Përzgjedh bimët zbukuruese dhe dekorative për mbjellje, sipas projektit;
- Zbaton me korrektësi projektin e arkitekturës së peizazhit;
- Koordinon bashkëpunimin me eprorët dhe specialistë të tjerë të kopshtarisë, sipas rregullores së brendshme;
- Dokumenton në mënyrë periodike punën e kryer, sipas formateve përkatëse;
- Raporton në mënyrë periodike për realizimin e detyrave, sipas formateve përkatëse.

NjN-08-III-0045-24 Kushtet klimatike dhe tokësore

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë ndikimin e kushteve klimatike në kultivimin e bimëve të kopshtarisë;
2. Të shpjegojë veprimin e faktorëve ekologjikë në rritjen e bimëve;
3. Të përshkruajë faktorët agrometeorologjikë që ndikojnë në rritjen dhe zhvillimin e bimëve;
4. Të përshkruajë teknologjinë digjitale për matjen dhe regjistrimin e parametrave agrometeorologjikë;
5. Të përshkruajë masat mbrojtëse ndaj dukurive ekstreme klimatike në kultivimin e bimëve të kopshtarisë;
6. Të shpjegojë llojet e tokave, cilësitë fiziko - kimike dhe karakteristikat e tyre;
7. Të përshkruajë mënyrat e marrjes së mostrave të tokës dhe teknikat e mostrimit;

8. Të shpjegojë rëndësinë e krahasimit të rezultateve të analizave me standardet përkatëse;
9. Të shpjegojë parimet bazë të kullimit dhe format e kullimit të tokave;
10. Të përshkruajë sistemet e ujitjes së bimëve.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të analizojë kushtet klimatike për kulturat e kopshtarisë;
2. Të analizojë kushtet tokësore dhe ujore për kulturat e kopshtarisë.

Kritere vlerësimi

- Përcakton kushtet mjedisore të nevojshme për kultivimin e bimëve të kopshtit, sipas kërkesave të bimëve;
- Grumbullon dhe analizon informacionin klimatik sipas mënyrave përkatëse;
- Kryen matje dhe regjistrime digjitale/analoge të parametrave klimatikë, sipas teknikave përkatëse;
- Krahason të dhënat e parametrave klimatikë me kërkesat e bimëve të kopshtarisë për të vlerësuar kushtet e përshtatshme për kultivim;
- Përzgjedh bimët e kopshtarisë sipas karakteristikave të klimës, tokës dhe ujit;
- Analizon llojet e tokave sipas karakteristikave të tyre;
- Merr mostrat e tokës për analiza, sipas teknikave përkatëse;
- Krahason të dhënat e laboratorit mbi cilësitë fiziko - kimike të tokës, sipas kërkesave të bimëve të kopshtarisë;
- Krahason faktorët hidrologjikë (reshjet, rrjedhjet, infiltrimi, evapotranspirimi) që ndikojnë në kultivimin e bimëve të kopshtarisë, sipas kërkesave të tyre;
- Ndërton një sistem kullimi, sipas standardeve;
- Sistemon kopshtin, sipas procedurës dhe projektit;
- Ndërton një sistem ujitje, sipas llojit të bimëve të kopshtarisë;
- Zbaton masat mbrojtëse ndaj dukurive ekstreme klimatike (thatësi, përmbytje, ngrica, breshër, zjarre etj.) për kultivimin e bimëve të kopshtarisë.

NjN-08-III-0046-24 Teknologjia e prodhimit të bimëve zbukuruese dhe dekorative

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë zhvillimin e kopshteve në periudha të ndryshme kohore;
2. Të përshkruajë rëndësinë dhe vlerat e kopshtarisë;
3. Të përshkruajë rëndësinë e renditjes së bimëve të kopshtarisë sipas kërkesave të tyre;
4. Të përshkruajë rëndësinë e kombinimit të bimëve të kopshtit për shfrytëzimin racional të tokës;
5. Të shpjegojë klasifikimin e kopshteve sipas përdorimit dhe destinacionit;
6. Të përshkruajë rolin dhe elementët përbërës të hapësirave të gjelbra;
7. Të përshkruajë teknologjitë e kultivimit të bimëve të kopshtarisë;
8. Të shpjegojë llojet e bimëve zbukuruese dhe dekorative një, dy dhe shumëvjeçare si dhe përdorimin e tyre;
9. Të përshkruajë mjediset e mbrojtura në të cilat organizohet prodhimi i bimëve zbukuruese dhe dekorative;
10. Të përshkruajë kultivimin dhe llojet kryesore të tapeteve të barit;
11. Të përshkruajë kultivimin dhe llojet kryesore të mureve të gjelbra;
12. Të përshkruajë llojet, karakteristikat dhe mënyrat e rritjes së bimëve zbukuruese për ambiente të brendshme;
13. Të shpjegojë hapat për ndërtimin dhe zbatimin e projekteve të thjeshta për krijimin e

- hapësirave të gjelbra;
14. Të shpjegojë llojet e plehrave, sipas mënyrës së përdorimit;
 15. Të përshkruajë mënyrën e sistemimit të tokës për krijimin e kopshtit;
 16. Të përshkruajë sistemet e kullimit dhe ujitjes së tokës për kultivimin e bimëve të kopshtit;
 17. Të përshkruajë sistemet e ndriçimit dhe vendosjen e elementëve të tjerë në kopsht;
 18. Të përshkruajë kushtet e nevojshme për krijimin e habitateve të jetës së egër në kopsht;
 19. Të përshkruajë punimet përgatitore për ngritjen e farishtës të prodhimit të fidanëve;
 20. Të përshkruajë punimet përgatitore për ngritjen e fidanishtes për prodhimin e fidanëve;
 21. Të përshkruajë proceset e punës për përgatitjen e fidanëve sipas standardeve;
 22. Të përshkruajë teknikat për punimet përgatitore të tokës për mbjelljen e farës/fidanëve;
 23. Të përshkruajë shërbimet agroteknike që kryhen në farishte/fidanishte të kopshtit;
 24. Të përshkruajë cilësitë fiziko-kimike të materialit mbjellës;
 25. Të përshkruajë teknikat e shartimit të bimëve të kopshtarisë;
 26. Të përshkruajë mënyrat për punimet bazë dhe ato përgatitore të tokës për mbjellje;
 27. Të përshkruajë mënyrat dhe teknikat për mbjelljen e farave dhe fidanëve në vendin e përhershëm;
 28. Të përshkruajë shërbimet agroteknike që kryhen për mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra;
 29. Të përshkruajë teknikën e përpunimit të plehrave organike dhe kompostimit të mbetjeve bimore të kopshtit.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbatojë projektin për ngritjen e kopshtit;
2. Të zbatojë teknologjinë e kultivimit të bimëve të kopshtit;
3. Të kryejë shërbime mirëmbajtjeje në kopsht.

Kritere vlerësimi

- Përcakton vendin për ngritjen e kopshtit sipas kushteve të terrenit;
- Përzgjedh bimët e kopshtit sipas qëllimit të kultivimit, përdorimit dhe kërkesave të tyre;
- Kombinon bimët e kopshtit për shfrytëzimin racional të tokës sipas projektit;
- Planifikon hapësirat e gjelbra për shfrytëzimin racional të tokës sipas projektit;
- Krijon skica për ngritjen e një kopshti të thjeshtë sipas projektit;
- Zbaton projekte të thjeshta për krijimin e hapësirave të gjelbra, sipas qëllimit të shfrytëzimit të tyre;
- Pastron dhe sistemon vendin për ngritjen e kopshtit sipas procedurës dhe projektit;
- Përzgjedh teknologjitë e kultivimit të bimëve të kopshtarisë, sipas llojit të bimëve;
- Zbaton teknologjitë e kultivimit të bimëve të kopshtarisë sipas llojit të tyre;
- Zbaton teknologjitë e kultivimit të tapeteve të barit, sipas projektit;
- Zbaton teknologjitë e kultivimit të mureve të gjelbra, sipas projektit;
- Vendos ndriçimin dhe elementë të tjerë në kopsht, sipas projektit;
- Krijon hapësirat e nevojshme për habitate të jetës së egër në kopsht, sipas projektit;
- Kryen punimet përgatitore për ngritjen e farishtës/fidanishtës së prodhimit të fidanëve sipas teknologjisë;
- Sharton bimët e kopshtarisë sipas teknikave përkatëse;
- Përgatit fidanët e kopshtarisë sipas standardeve;
- Zbaton teknikat për punimet e tokës shoqëruar me plehërim organik dhe mineral për mbjelljen e farës/fidanëve;
- Përzgjedh materialin mbjellës (farë, fidanë) sipas cilësive specifike;

- Mbjell fara dhe fidanë në vendin e përhershëm, sipas teknikave dhe projektit;
- Kryen punimet plotësuese të tokës në kopsht sipas teknikave përkatëse;
- Përzgjedh plehrat sipas mënyrës së përdorimit;
- Kryen plehërimin plotësues me plehra organike dhe minerale sipas kërkesave dhe teknikës përkatëse;
- Kryen ujitjen e bimëve sipas nevojave;
- Kryen shërbimet agroteknike për mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra sipas kërkesave;
- Kryen krasitjen e bimëve të kopshtit sipas teknikave përkatëse;
- Kryen trajtime kundër sëmundjeve dhe dëmtuesve në kopsht sipas protokolleve;
- Komposton plehrat organike dhe mbetjet bimore të kopshtit sipas teknikave.

NjN-08-III-0047-24 Produktet përfundimtare të bimëve zbukuruese dhe dekorative

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë mënyrat, teknikat dhe kohën e marrjes së luleve, pjesëve vegjetative dhe farës;
2. Të përshkruajë teknikat e grumbullimit të produktit;
3. Të shpjegojë rëndësinë e përpunimit të produkteve kopshtare;
4. Të përshkruajë procese të thjeshta të përpunimit të produkteve të kopshtarisë;
5. Të përshkruajë mënyrën e krijimit të buqetave me lule të freskëta/thata;
6. Të shpjegojë mënyrat e tharjes së luleve dhe bimëve dekorative;
7. Të përshkruajë teknikat e vjeljes së farës;
8. Të shpjegojë mënyrat e pastrimit dhe seleksionimit sipas llojit të produktit;
9. Të përshkruajë llojet dhe mënyrat e ambalazhimit dhe etiketimit të produktit;
10. Të shpjegojë mënyrat e transportit të sigurt të prodhimeve të kopshtarisë;
11. Të shpjegojë kushtet e magazinimit dhe e ruajtjes së produktit;
12. Të argumentojë rëndësinë e kontrollit digjital të parametrave për ruajtjen e produktit;
13. Të shpjegojë masat mbrojtëse ndaj dëmtuesve të produktit në ruajtje.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbatojë teknikat e vjeljes;
2. Të përgatitë produkte përfundimtare të kopshtit;
3. Të monitorojë kushtet e magazinimit.

Kritere vlerësimi

- Zbaton teknikat e marrjes së luleve dhe pjesëve vegjetative;
- Zbaton teknikat e vjeljes së farës/copave;
- Kryen pastrimin dhe seleksionimin sipas llojit të produktit;
- Grumbullon, ambalazhoni dhe etiketoni produktet kopshtare sipas standardeve;
- Krijon buqeta me lule të freskëta dhe të thata sipas kërkesës;
- Kryen tharjen e luleve dhe bimëve sipas teknikave përkatëse;
- Monitoron kushtet e magazinimit dhe të ruajtjes së produktit sipas standardeve;
- Transporton prodhimet e kopshtarisë, sipas standardeve;
- Kontrollon në mënyrë digjitale/analoge parametrat për ruajtjen e produktit, sipas standardeve;
- Zbaton masat mbrojtëse ndaj dëmtuesve të produktit në ruajtje sipas protokolleve.

NjN-23-III-0013-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë parimet bazë të kodit të punës dhe legjislacionin përkatës lidhur me aktivitetin që kryen;
2. Të shpjegojë format dhe mënyrat e përpilimit dhe arkivimit të dokumentacioneve;
3. Të shpjegojë mënyrat e llogaritjeve të materialeve të punës;
4. Të përshkruajë mënyrat e hartimit të grafikut të punës;
5. Të shpjegojë mënyrat e regjistrimit të të dhënave për faturat dhe ofertat;
6. Të argumentojë rëndësinë e informimit nga tregu për çmimet dhe cilësinë e mjeteve, materialeve, pajisjeve dhe produkteve;
7. Të shpjegojë elementët e llogaritjes së kostos së mjeteve, materialeve dhe pajisjeve të punës;
8. Të shpjegojë mënyrat e përgatitjes së një oferte për produktet që do të ofrojnë;
9. Të shpjegojë mënyrat e blerjes së mjeteve, materialeve, dhe pajisjeve të nevojshme;
10. Të shpjegojë teknikat e marketingut për produktet kopshtare;
11. Të përshkruajë llojet e institucioneve financiare dhe shërbimet e tyre;
12. Të përshkruajë nocionin e të ardhurave dhe shpenzimeve në kopshtari;
13. Të përshkruajë mënyrat e analizimit të vetvetes;
14. Të përshkruajë metodat e zhvillimit profesional dhe të karrierës;
15. Të argumentojë rëndësinë e teknologjisë bashkëkohore për proceset e punës në specialitetin e kopshtarisë;
16. Të përshkruajë mënyrat e transmetimit në kohë tek bashkëpunëtorët të njohurive dhe aplikimin e teknikave të reja në punë;
17. Të argumentojë rëndësinë e pjesëmarrjes në panaire dhe ekspozita;
18. Të përshkruajë llojet e trajnimeve dhe kurseve teknike.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbatojë detyra administrative dhe tregtare;
2. Të zbatojë teknikat e marketingut;
3. Të zhvillohet profesionalisht.

Kritere vlerësimi

- Zbaton legjislacionin tatimor, kodin e punës dhe legjislacionin e fushës;
- Plotëson planin e punës në përputhje me detyrën e dhënë;
- Kryen llogaritje të thjeshta ekonomike sipas rregullave;
- Zbaton grafikun e punës, sipas proceseve;
- Kryen blerjen e mjeteve, materialeve, dhe pajisjeve të nevojshme sipas nevojës;
- Zbaton teknikat e marketingut për prodhimet kopshtare;
- Plotëson dokumentacionin për bashkëpunimet me institucionet financiare dhe shërbimet e tyre;
- Përgatit oferta për produktet referuar çmimeve aktuale të tregut;
- Regjistron të dhënat e faturave të shitjes dhe marrjes së porosive sipas kërkesës;
- Llogarit çmimin përfundimtar për prodhimet sipas rregullave;
- Merr informacion nga tregu për çmimet dhe cilësinë e inputeve bujqësore;
- Kryen vazhdimisht trajnime për zhvillimin profesional dhe të karrierës;
- Merr pjesë vazhdimisht në panaire dhe ekspozita në fushën e kopshtarisë;
- Përdor teknologjinë bashkëkohore për proceset e punës në kopshtari, sipas rregullave;
- Informon në kohë bashkëpunëtorët për zbatimin e teknikave të reja në kopshtari.

NjN-22-III-0014-24 Komunikimi dhe etika profesionale

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë mënyrat e dhënies/marrjes së informacionit për problemet dhe të rejat e ditës;
2. Të shpjegojë metodat e komunikimit;
3. Të argumentojë zbatimin e parimeve të punës në grup;
4. Të shpjegojë rregullat bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal;
5. Të shpjegojë kodin e etikës profesionale;
6. Të përshkruajë metodat e zgjidhjes së problemeve dhe mendimit kritik;
7. Të përshkruajë mënyrat e bashkëpunimit më eprorët dhe kolegët;
8. Të shpjegojë përdorimin e TIK në komunikimin me të tjerët;
9. Të argumentojë përdorimin e terminologjisë profesionale;
10. Të argumentojë rëndësinë e respektimit të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë teknikat e komunikimit;
2. Të zbatojë kodin e etikës;
3. Të zbatojë terminologjinë profesionale të kopshtarisë.

Kritere vlerësimi

- Merr informacion të vazhdueshëm mbi problemet dhe të rejat e ditës;
- Zbaton parimet e punës në grup;
- Zbaton rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal me eprorët dhe kolegët;
- Zbaton teknikat e komunikimit për të arritur një komunikim efektiv;
- Zbaton kodin e etikës në mënyrë korrekte;
- Zbaton teknikat për zgjidhjen e problemeve dhe mosmarrëveshjeve;
- Bashkëpunon me eprorët dhe kolegët sipas rregullores së brendshme;
- Përdor saktë terminologjinë profesionale
- Zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.

NjN-08-III-0048-24 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në kopshtari

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të legjislacionit në fuqi për sigurimin teknik dhe ruajtjen e mjedisit;
2. Të përshkruajë rregullat për mbrojtjen e mjedisit dhe standardet ekologjike;
3. Të përshkruajë masat e sigurisë në punë;
4. Të shpjegojë mënyrën e përdorimit të pajisjeve të mbrojtjes personale dhe kolektive;
5. Të shpjegojë mënyrën e asgjësimit të produkteve të dëmshme;
6. Të përshkruajë sinjalistikën në mjediset e punës;
7. Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të planit të evakuimit në raste emergjence;
8. Të përshkruajë rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit;

9. Të rendisë llojet e mjeteve të ndihmës së parë;
10. Të përshkruajë mënyrën e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti;
11. Të përshkruajë mënyrën e raportimit sipas rastit të personat përgjegjës për mosfunksionimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës;
12. Të përshkruajë mënyrën e grumbullimit, largimit, përpunimit dhe përdorimit të përshtatshëm të mbetjeve kopshtare në përputhje me rregulloret për mbrojtjen e mjedisit;
13. Të përshkruajë rregullat e sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit;
14. Të përshkruajë mënyrën e menaxhimit të mbetjeve kimike të përdorura në proceset e punës;
15. Të përshkruajë përdorimin në mënyrë racionale të burimeve ujore për zhvillim të qëndrueshëm;
16. Të shpjegojë mënyrën e zbatimit të protokolleve në raste endemie dhe pandemie;
17. Të përshkruajë rregullat e higjienës personale dhe të pajisjeve mbrojtëse në punë;
18. Të përshkruajë proceset bujqësore për të përdorur energji dhe materiale në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjes së mjedisit.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbatojë standardet e sigurimit teknik në punë;
2. Të zbatojë procedurat për mbrojtjen e shëndetit;
3. Të zbatojë procedurat për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton legjislacionin në fuqi për sigurimin teknik;
- Zbaton rregullat për mbrojtjen e mjedisit dhe standardet ekologjike;
- Kontrollon funksionalitetin e mjeteve dhe pajisjeve të sigurimit teknik, sipas manualeve;
- Raporton sipas rastit të personat përgjegjës për mosfunksionimin e mjeteve dhe pajisjeve të sigurimit teknik;
- Përdor pajisjet e MZSH sipas rregullave;
- Respekton sinjalistikën përkatëse sipas rregullores së brendshme;
- Zbaton masat e sigurisë në punë sipas legjislacionit;
- Zbaton rregullat për parandalimin e aksidenteve sipas legjislacionit;
- Zbaton procedurat për dhënien e ndihmës së parë;
- Zbaton procedurat për evakuim në rast emergjencash;
- Zbaton protokollet e duhura në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme;
- Zbaton rregullat e higjienës personale dhe të pajisjeve mbrojtëse në punë;
- Zbaton procedurat e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm;
- Përdor në mënyrë efikase burimet: ujë, energji, etj.;
- Zbaton procedurat për ndarjen e mbetjeve kopshtare sipas llojit;
- Përdor pajisjet e mbrojtjes personale dhe kolektive sipas manualeve;
- Zbaton rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit;
- Kryen grumbullimin, largimin dhe përpunimin e mbetjeve të prodhimit në përputhje me rregulloret për mbrojtjen e mjedisit;
- Zbaton rregullat e sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit.

Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:

Nr.	Njësi të nxëni	Peshat në %	Kodet
1	Planifikimi dhe organizimi i punës në kopshtari	20	NjN-08-III-0044-24
2	Kushtet klimatike dhe tokësore	15	NjN-08-III-0045-24
3	Teknologjia e prodhimit të bimëve zbukuruese dhe dekorative	30	NjN-08-III-0046-24
4	Produktet përfundimtare të bimëve zbukuruese dhe dekorative	15	NjN-08-III-0047-24
5	Sipërmarrje dhe edukim karriere	5	NjN-23-III-0013-24
6	Komunikimi dhe etika profesionale	6	NjN-22-III-0014-24
7	Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në kopshtari	9	NjN-08-III-0048-24
Totali		100	

Modalitetet e vlerësimit

Me vlerësim kuptojmë procesin gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së një rezultati të nxëni (RN), mbi bazën e kriterëve të caktuar.

Për vlerësimin mund të përdoren një shumëllojshmëri metodash standarde dhe inovatore.

Individi i nënshtrohet vlerësimit të vazhduar, përmbledhës dhe vlerësimit përfundimtar për kualifikimet formale që ofrohen në ofrues të akredituar.

Individi vlerësohet për shkallën e përvetësimit të kompetencave të përgjithshme dhe profesionale, të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën përkatëse dhe vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së RN për realizimin e tërësisë së proceseve duke mbajtur evidenca për qëllime dokumentimi.

Realizimi i pranueshëm do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të specifikuar.

Dhënia e rezultatit të vlerësimit bëhet sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Kompetencat e përgjithshme vlerësohen të integruara si pjesë e vlerësimit të njësive të të nxënit.

Individit i lind e drejta të certifikohet për njësitë të nxëni specifike, si një kualifikim i pjesshëm sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Informacion shtesë

Kualifikimet e plota ose të pjesshme profesionale mund të përftohen nëpërmjet këtyre formave:

- ndjekjes së arsimit profesional me bazë shkollën;
- ndjekjes së kurseve profesionale, ku përfshihen edhe praktikat profesionale në ndërmarrje apo forma të tjera të mësimnxënies praktike;
- regjistrimit si nxënës, duke u punësuar në një ndërmarrje (forma e dyfishtë);
- njohjes të të nxënit të mëparshëm informal dhe joformal;
- njohjes të të nxënit të përfutur jashtë vendit;

dh) formave të tjera të përcaktuara me ligj.

SHËNIM

Shpjegime të kodit të kualifikimit: **H5-III-24**

H - Shkronja që identifikon fushën e kualifikimit

5 - Numri që identifikon profilin/specializimin e kualifikimit përkatës

III - Shifra që identifikon nivelin sipas KSHK

24 - Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar kualifikimi

Shpjegime të kodit të njësisë së të nxënit: **NjN-08-III-0044-24**

NjN - Shkronjat që tregojnë se kodi i referohet Njësive të të Nxënit

08 - Numri që identifikon orientimin e Njësisë së të Nxënit

III - Shifra që tregon nivelin e Njësisë së të Nxënit në strukturën e KSHK

0044 - Numri rritës progresiv që tregon gjendjen e Njësive të të Nxënit në ditën e hartimit përkatës

24 - Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar Njësia e të Nxënit